



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Menaxhmenti Financiar EKB0028

| | |
|-------------------|----------------------------|
| Data e aprovimit: | Data |
| Verzioni: | Verzion |
| ECTS: | 8 |
| Bartësi i lëndës: | Ilire Mehmeti |
| Email: | ilire.mehmeti@riinvest.net |
| Telefoni: | 038 224 322 |

Hyrje:

Të nderuar studentë: JU shpreh mirëseardhje në këtë lëndë të cilën do ta zhvillojmë së bashku. Lënda parasheh t'i mbajmë dy (2) orë ligjaratë dhe një (1) orë ushtrime gjatë javës. Shpresoj se do të kalojmë mirë së bashku dhe pres gjithëherë të jeni të lirë dhe të hapur për diskutim gjatë tërë semestrit në këtë lëndë. SuksesE

Qëllimet

Objektivat e kësaj lënde janë që: 1. Të ekspozohen studentët me problemet themelore financiare që hasin bizneset. 2. Të paraqiten rolet kyçe të menaxherit financiar në biznese. 3. Të kuptojnë studentët çështjet themelore të organizimit dhe fushëveprimit të financave në biznese dhe të menaxhimit të tyre. 4. Të njihen studentët me situatat financiare të tregut të kapitalit. 6. Të njihen studentët me hapat e vendimmarrjes në investime dhe financime gjithëherë duke pasUR parasysh maksimizimin e vlerës së firmes dhe asetëve të saja.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:
 - Përshkruajnë dhe kuptojnë konfliktet që ndodhin mes pronarëve dhe menaxherëve në biznese.
 - Marrin vendime profitabile duke analizuar situatën financiare dhe objektivat e biznesit
 - Aplikojnë konceptet financiare në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që hasin bizneset.

Programi

| Java | Tema | Aktivitetet |
|------|---|------------------------|
| 1 | Hyrje në Lëndën Menaxhmenti Financiar. Diskutimi i syllabusit dhe përshkrimi i lëndës | Diskutim i syllabusit |
| 2 | Vlera në kohë e parësë | Ligjeratë |
| 3 | Vlera në kohë e parësë - Vazhdim | Ligjeratë dhe ushtrime |

| Nr. | Vlera në kohë e parasë - Vazhdim | Ligjeratë dhe ushtrime |
|-----|--|---|
| 4 | Vlera në kohë e parasë - Vazhdim | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 5 | Kriteret e vendimmarrjes financiare | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 6 | Pasqyrat dhe analiza financiare | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 7 | Planifikimi financiar | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 8 | Testi 1 | Do të përfshin materialin e mbuluar deri në javën 7 |
| 9 | Investimet | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 10 | Risku dhe menaxhimi i tij | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 11 | Burimet afatshkurta dhe afatmesme të financimit | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 12 | Burimet afatgjata të financimit | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 13 | Kostoja e kapitalit | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 14 | Përsëritje - rikapitulum i lëndës | Ligjeratë dhe ushtrime |
| 15 | Diskutim për provim final dhe përmbyllje e semestrit | Permbyllje e semestrit |

Informata shtesë 1:

Ne kete lende pjesa teorike e zhvilluar dhe konceptet e elaboruara do te ndihmojne studentet ne kuptuesmerine e botes reale te financave. Studentet do te kene mundesine te kuptojne se si praktikisht funksionojne financat ne biznese. Gjithashtu, pjesa teorike do te u ndihmoje qe pas perfundimit te studimeve, studentet te kene njohuri te mjaftuara per punesim ne institucionet financiare.

Informata shtesë 2:

Gjate ligjeratave do te perdoret kompjuteri me Power Point slides, ndersa gjate ushtrimeve do te shtjellohen detyra. Studentet do te pergatisin seminare dhe prezantime duke analizuar pasqyrat financiare te bizneseve dhe firmave te ndryshme.

Vlerësimi:

| Nr. | Lloji Vleresimit | Perqindja | Pershkrimi |
|-----|------------------|-----------|---|
| 1 | Pjesëmarrja | 10 | Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrime. |
| 2 | Detyra | 15 | 3 Kuize/Detyra të shtëpisë(5% secila) |
| 3 | Test | 25 | Testi i parë do të mbahet në javën e 7. |
| 4 | Provimi Final | 50 | Provimi final do të mbahet pas javës së 15 (pesëmbëdhjetë) atëherë kur caktohet nga administrata. |

Kushtet e përsëritjes:

- Sipas rregullore së studentëve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë deri në tri herë të tentojë ta kalojë lëndën. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (vijueshmëria, vlerësimet e kollokviumeve) gjatë ligjëratave i ruhen studentit deri në afatin e fundit që e ka për ta dhënë këtë lëndë. - Nëse studenti nuk arrin ta kalojë lëndën deri në mundësinë e tretë që është në afatin e Shtatorit, atëherë studenti duhet ta përsëris komplet lëndën edhe një herë.

Burimet:

- Obligative: Mustafa, I. (2008). Menaxhmenti Financiar. Botimi i tretë. Prishtinë. Instituti për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST. Rekomandohen: Brealey,A.R.,Myers,C.S. and Allen,F.(2008).Principles of Corporate Finance.(9th Edition).USA. McGraw Hill. Ross,S.A.,Westerfield, R.W.,& Jordan,B.D.(2008. Corporate Finance Fundamentals. (8th Edition).New York.McGraw Hill

Ndërtimi i ECTS-ve

| Aktiviteti | Nr i oreve per Aktivitetin | |
|--------------------------------|----------------------------|--|
| Ligjerata: | 30 | |
| Ushtrime: | 30 | |
| L+U: | 60 | |
| Seminar/praktike.: | 30 | |
| Studim i vazhdushem: | 80 | |
| Pregaditja e Provimit: | 20 | |
| Pjesemarrja ne teste: | 4 | |
| Pjesemarrja ne provimin final: | 3 | |
| Me profesorin dhe asistentin: | 4 | |
| Total Ore: | 201 | |
| ECTS: | 8 | |